

VENDIM
Nr.47, datë 28.7.2010

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV
PRIVAT KABLLOR “AVN”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Sami Neza	anëtar
Suela Musta	anëtare
Gent Ibrahim	anëtar
Zylyftar Bregu	anëtar

pasi mori në shqyrtim çështjen me:

Objekt: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “AVN”.

Baza ligjore: Neni 7 pika 21 dhe neni 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, të miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, vendimi nr.515, datë 9.10.2006 i KKRT-së, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VËREN SE:

KKRT, me vendimin nr.279, datë 29.10.2004, ka licencuar shoqërinë “AVN+15”, sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor në qytetin e Fierit, për një periudhë prej 6 vjetësh. Për shkelje të dispozitave të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, KKRT, me vendimin nr.515, datë 9.10.2006, vendosi të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës në masën 50% të afatit të saj. Afati i vlefshmërisë së licencës për subjektin televiziv privat kabllor AVN ka përfunduar më datë 12.11.2007.

Në mbledhjen e datës 14.11.2007, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit vendosi të mos hapë aplikimin për rinovimin e licencës për TV kabllor AVN, duke ia kaluar për shqyrtim KKRT-së, pasi ky subjekt e kishte paraqitur dosjen e aplikimit pas përfundimit të afatit të përcaktuar në shkresën nr.745 prot., datë 11.7.2007 të KKRT-së.

Në mbledhjen e datës 26.2.2008, Komisioni i Shqyrtimit të Dokumentacionit vendosi të shqyrtojë aplikimin për rinovimin e licencës për TV kabllor AVN, pasi më parë KKRT kishte rënë dakord në mbledhjen e saj të radhës, që këtij subjekti t’i hapej dosja e rinovimit të licencës. Në fazën e parë të shqyrtimit të dosjes, TV kabllor AVN nuk arriti të kualifikohet, pasi ky subjekt kishte detyrime financiare të pashlyera.

Bazuar në vendimin nr.704, datë 16.7.2008, KKRT vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin “TV kabllor AVN”, për shkak të mosshlyerjes së detyrimeve financiare. Pas shlyerjes së detyrimeve financiare, KKRT vendosi që të shqyrtojë aplikimin e paraqitur nga subjekti “TV kabllor AVN” për rinovimin e licencës.

Mbështetur në vendimin nr.842, datë 24.4.2009 “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor AVN”, KKRT vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës për subjektin “TV kabllor AVN”, pasi nuk kishte depozituar deklaratën mbi vërtetësinë e të dhënave dhe deklaratën përkatëse noteriale; nuk kishte paraqitur kontratat e punës dhe pagesat e sigurimeve shoqërore për personat e punësuar.

KKRT vëren se gjatë kohës së vlefshmërisë së licencës nuk ka qenë i rregullt në zbatimin

e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar. Konkretisht, për transmetimin e programeve pa të drejta transmetimi, KKRT, me vendimin nr.515, datë 9.10.2006, ka vendosur të reduktojë kohën e vlefshmërisë së licencës në masën 50% të afatit të saj. Edhe pse afati i vlefshmërisë së licencës për subjektin televiziv privat kabllor AVN ka përfunduar më datë 12.11.2007, ky subjekt ka vazhduar të transmetojë programe pa të drejta transmetimi, në kundërshtim me nenin 40/1 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar. Për pirateri, subjekti është ndëshkuar me sanksionet me gjobë nr.198, datë 12.10.2009 në masën 500 000 (pesëqind mijë) lekë dhe nr.255, datë 22.6.2010, në masën 800 000 (tetëqind mijë) lekë.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25, 40/1 dhe 33 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.515, datë 9.10.2006 të KKRT-së, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.162, datë 29.8.2003 të KKRT-së, si dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.022/RTV kabllor, të subjektit radiofonik privat kabllor “TV kabllor AVN”.
2. Licenca me nr.022/RTV kabllor “AVN” bëhet e pavlefshme.
3. Subjekti, sipas pikës 1, të ndërpresë menjëherë transmetimin.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda një muaji në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati